

# RRUGA DREJT MARRËVESHJES FINALE

## PERCEPTIMET E QYTETARËVE NË KOSOVË DHE SERBI PËR DIALOGUN POLITIK DHE IDENTITETIN

**B S** BAROMETRI I  
SIGURISË NË  
**B P** BALLKANIN  
PERËNDIMOR

**2020** EDICIONI I PARË  
RAJONAL I ANKETËS

## **Shënim: Ky raport, në formën e tij origjinale, është shkruar në gjuhën angleze.**

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat dhe pronësia intelektuale mbrohen me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

Raporti botohet nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë dhe Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë. Perceptimet e prezantuara në këtë raport janë përmbledhje e informacionit të mbledhur nga të anketuarit dhe demonstrojnë vetëm atë se si qytetarët i perceptojnë çështjet e interpretuara në raport. Ato në asnjë mënyrë nuk janë vlerësim përfundimtar i cilësisë së punës së institucioneve ose çështjeve që i përmban ky studim. Kjo do të shërbejë si instrument për adresimin e mangësive të mundshme, por edhe tregues i efektivitetit të komunikimit të tyre me qytetarët.

Pikëpamjet e paraqitura në këtë raport janë perceptimet e të anketuarve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë dhe të Qendrës së Beogradit për Politika të Sigurisë. Opinionet e shprehura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e National Endowment for Democracy (NED).

# RRUGA DREJT MARRËVESHJES FINALE

## PERCEPTIMET E QYTETARËVE NË KOSOVË DHE SERBI PËR DIALOGUN POLITIK DHE IDENTITETIN



# PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE KRAHASUESE.....</b>	<b>2</b>
<b>1. KAPITULLI PËR KOSOVËN.....</b>	<b>6</b>
1.1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
1.2. PIKËPAMJET E KOSOVARËVE PËR DIALOGUN KOSOVË-SERBI.....	8
1.3. PERCEPTIMET E IDENTITETIT NDAJ SERBISË.....	14
<b>2. KAPITULLI PËR SERBINË.....</b>	<b>16</b>
1.1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	7
2.2. PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR DIALOGUN MES KOSOVËS DHE SERBISË.....	17
2.3. PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR ÇËSHTJET E IDENTITETIT.....	21
<b>METODOLOGJIA.....</b>	<b>22</b>

# PËRMBLEDHJE KRAHASUESE

**Autor:**

**Ramadan Ilazi, Hulumtues i lartë**

# “Pesimizëm për të ardhmen, por qytetarët pajtohen deri-diku se ka mangësi në ecurinë e dialogut Kosovë-Serbi”

Dialogu i udhëhequr nga BE për normalizimin e marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë supozohet të jetë çështja kryesore për të dyja vendet që kur filloi ky proces në vitin 2011. Pas gati një dekade të këtij procesi dhe në disa raste të raportimit negativ nga mediat, qytetarët e Serbisë dhe të Kosovës duket se e mbështesin relativisht fuqishëm dialogun. Përqindja në mbështetje të dialogut është paksa e ndryshme në Kosovë dhe Serbi. Qytetarët në Kosovë duket se kanë një mbështetje më të fortë me 68 për qind krahasuar me qytetarët serbë me rreth 51 për qind. Kjo përqindje relativisht e lartë e mbështetjes për dialogun në të dy vendet sfidon supozimin e përbashkët se dialogu nuk është i popullarizuar. Kjo duket se sugjeron që qytetarët shohin vlerë dhe përfitim në procesin e dialogut. Sidoqoftë, ky supozim minohet me përqindjen shumë të lartë të qytetarëve në Kosovë (80 për qind) dhe Serbi (92 për qind) që nuk shohin ndonjë përfitim personal nga dialogu. Ky rezultat mund të nënkuptojë se qytetarët e shohin dialogun si përgjegjësi të elitave ose proces që ndodh në nivelin makro, duke mos ua prekur jetën atyre. Ndoshta përqindja e lartë e qytetarëve në të dyja vendet që nuk e perceptojnë dialogun me përfitime personale është manifestim i mungesës së komunikimit efektiv në lidhje me përfitimet e dialogut nga BE-ja dhe ajo çka është më me rëndësi nga qeveritë në Kosovë e Serbi.

Perceptimet negative të qytetarëve ndaj përfitimeve të dialogut duket se lidhen me perceptimet e qytetarëve për transparencën e procesit. Në Serbi, vetëm 18 për qind kanë thënë se e kanë njohuri për përmbajtjen e dialogut dhe e kanë konsideruar atë si transparent, kurse në Kosovë kjo shifër është edhe më e ulët prej 11 për qind sosh. Në këtë kuptim, del një emërues i përbashkët për të dyja shoqëritë, pasi qytetarët në të dyja vendet duket se pajtohen që dialogut i mungon transparenca. Në Serbi, 82 për qind e qytetarëve janë shprehur se dialogu është pjesërisht ose aspak transparent, ndërsa në Kosovë 77 për qind janë deklaruar se dialogu nuk është transparent ose i mungon plotësisht transparenca. Transparenca ose sipërfaqja e saj është sfidë e qenësishme me proceset e lehtësimeve/ndërmjetësimit të mosmarrëveshjeve midis palëve. Lehtësuesit përballen me dilemën e vështirë se kur, çka dhe sa t'i zbulojnë publikut, në mënyrë që të mos prishin a krijojnë reagime të mundshme në zgjidhjet e mundshme të kompromisit.

Njëra nga pasojat e mundshme të perceptimeve të larta midis qytetarët për mungesën e transparencës së dialogut është edhe perceptimi i tyre për ndikimin e procesit të dialogut. Në këtë kontekst, një tjetër emërues i përbashkët midis qytetarëve kosovarë dhe serbë është se shumica e tyre, 60 për qind në Kosovë dhe 71 për qind në Serbi, duket se besojnë që dialogu nuk ka ndryshuar asgjë. Kjo lidhet edhe me nivelin e vetëdijesimit në mesin e qytetarëve për qëllimet aktuale të procesit të dialogut. Në Serbi 50 për qind e qytetarëve janë përgjigjur se nuk i dinë qëllimet e procesit të dialogut krahasuar me 31 për qind në Kosovë. Por rezultati është shumë i ndryshëm sa i përket asaj se çka konkretisht qytetarët në Kosovë dhe Serbi besojnë për qëllimin e dialogut. Gjersa, 37 për qind e qytetarëve kosovarë besojnë se qëllimi është njohja e ndërsjellë, 21 për qind e qytetarëve serbë besojnë se bëhet fjalë për ruajtjen e territorit/Kosovës. Këto të dhëna nënkuptojnë se ka probleme thelbësore për mënyrën se si qeveritë në të dyja vendet komunikojnë me qytetarët e tyre ose më konkretisht me mungesën e ndershmërisë në këtë drejtim. Që nga fillimi i procesit të dialogut më 2011, BE-ja qëllimisht nuk ka qenë e qartë në përkufizimin e objektivave të dialogut dhe rreth asaj se ç'do të thotë në të vërtetë normalizimi i marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Qasja e BE-së në dialog ka qenë e shoqëruar me një paqartësi konstruktive që i ka lejuar Kosovës dhe Serbisë të arrijnë marrëveshje duke injoruar elefantin në dhomë, por ndoshta pa dashje ka shkaktuar pasoja të mundshme serioze në menaxhimin e pritjeve tek të dyja shoqëritë. Një detaj interesant tek rezultatet e perceptimit të qytetarëve për qëllimet e dialogut të normalizimit është përqindja e vogël e qytetarëve që

identifikojnë integrimin evropian si një nga qëllimet e procesit, me vetëm 6 për qind në Kosovë, ndërsa në Serbi kjo nuk është regjistruar fare.

Sa i përket opsioneve të ndryshme për një zgjidhje kompromisi me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ndërmjet Serbisë dhe Kosovës lidhur me statusin e kësaj të fundit si shtet i pavarur, perceptimet e qytetarëve janë skajshmërisht të kundërta. Përderisa në Kosovë 77 për qind e qytetarëve besojnë se zgjidhja finale më e mirë nga procesi i dialogut do të ishte njohja e ndërsjellë mes Kosovës e Serbisë në kufijtë ekzistues, në anën tjetër 48 për qind e qytetarëve në Serbi besojnë se zgjidhja në fund duhet të jetë rikthimi i Kosovës në Serbi me autonomi më të gjerë. Është e rëndësishme të theksohet se në perceptimet e qytetarëve serbë rreth 18 për qind prej tyre e konsiderojnë themelimin e Asociacionit të Komunave Serbe pa njohje të shtetësisë si rezultat më të mirë. Kjo është e rëndësishme dhe inkurajuese pasi tregon potencialin për një zgjidhje kompromisi përmes së cilës Serbia pranon pavarësinë e Kosovës por nuk e njeh atë zyrtarisht që të paktën zgjidhja të jetë e pranueshme nga një segment i rëndësishëm i shoqërisë.

Optimizmi midis qytetarëve të Kosovës dhe Serbisë për marrëdhënie paqësore mes shqiptarëve dhe serbëve në Ballkan nuk është shumë i fortë. Ndërsa, qytetarët në Kosovë duken më optimistë, me 49 për qind që besojnë se do të ketë paqe mes serbëve dhe shqiptarëve në Ballkan, në Serbi vetëm 27 për qind e qytetarëve pajtohen me një perspektivë të tillë. Qytetarët nuk janë shumë pozitivë as në lidhje me të ardhmen e marrëdhënieve midis Kosovës e Serbisë. Përsëri, qytetarët kosovarë janë pak më optimistë, gjegjësisht 47 për qind e tyre besojnë se në të ardhmen e afërt do të ketë marrëdhënie paqësore dhe normale me Serbinë. Në rastin e Serbisë, 27 për qind e qytetarëve kanë besim se do të ketë marrëdhënie paqësore e normale me Kosovën në të ardhmen e afërt. Qytetarët serbë janë shumë pesimistë rreth perspektivave të një marrëveshjeje përfundimtare me Kosovën, me 53 për qind e tyre të cilët besojnë se kjo nuk do të ndodhë kurrë. Në rastin e Kosovës, 48 për qind besojnë se një marrëveshje përfundimtare me Serbinë do të arrihet në 3-5 vitet e ardhshme, krahasuar me 25 për qind të qytetarëve në Serbi.

Dallimet e qytetarëve të Kosovës dhe Serbisë në lidhje me marrëdhëniet e ardhshme janë të dukshme edhe kur ata pyeten nëse presin të normalizohen marrëdhëniet mes shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve në një të ardhme të afërt. Opsioni i dhënë në anketë për këtë temë ka qenë: "Po, por vetëm nëse arrihet një marrëveshje përfundimtare" në mbështetje së cilës janë deklaruar 43 për qind e qytetarëve kosovarë krahasuar me 29 për qind në Serbi. Shumica e qytetarëve serbë, 63 për qind e tyre, nuk besojnë se do të normalizohen marrëdhëniet me shqiptarët e Kosovës pavarësisht rezultatit të dialogut, që do të thotë edhe nëse do të ketë një marrëveshje përfundimtare ose përmbyllëse në kuadër të dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ky rezultat është shumë i rëndësishëm për t'u marrë parasysh pasi nënkupton që elitat politike të përfshira në normalizimin e marrëdhënieve nuk po e mbajnë shoqërinë me vete. Në këtë kuptim, normalizimi i marrëdhënieve nga qytetarët duket se perceptohet si nevojë politike dhe e izoluar në nivelin politik midis udhëheqësve. Kjo mbase sugjeron se edhe një marrëveshje përfundimtare e arritur midis dy vendeve në kuadër të dialogut të udhëhequr nga BE-ja, që ndoshta në sytë e BE-së si lehtësues ose aktorëve të tjerë do të shënonte arritjen e normalizimit, megjithatë në realitet qytetarët e Kosovës dhe posaçërisht ata të Serbisë nuk do ta shihnin ashtu. Ajo që duket se kjo nënkupton është se normalizimi i marrëdhënieve që dialogu i drejtuar nga BE kërkon të arrijë do të shtrihej kryesisht në mekanizmat shtetërorë të të dy vendeve dhe potenciali i tij ka shumë të ngjarë të mos përkthehet në shoqëritë përkatëse. Si rrjedhojë, përmbyllja e procesit të normalizimit të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë duhet të shënojë fillimin e procesit të pajtimit midis shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve.



# GJETJET KRYESORE:

- Shumica e qytetarëve të Kosovës dhe të Serbisë mbështesin procesin e dialogut, megjithatë kanë perceptime diametralisht të kundërt mbi arritjet e dialogut. Derisa shumica e qytetarëve të Kosovës besojnë se qëllimi i dialogut është njohja reciproke, në Serbi ekziston perceptimi se qëllimi i këtij procesi është kthimi i Kosovës në Serbi me një autonomi më të gjerë;
- Qytetarët e Kosovës dhe të Serbisë kryesisht ndajnë perceptimet negative për procesin e dialogut, transparencën e këtij procesi dhe ndikimin e tij. Shumica e qytetarëve të Kosovës dhe të Serbisë mendojnë se dialogut i mungonte transparenca, se nuk ka ndryshuar asgjë ose se vetë qytetarët nuk kanë pasur ndonjë përfitim nga procesi. Kjo tregon për një mangësi të konsiderueshme në qasjet e komunikimit të BE-së dhe të qeverisë së Kosovës dhe asaj të Serbisë;
- Qytetarët e Serbisë janë më pak optimistë në krahasim me qytetarët e Kosovës për të ardhmen e marrëdhënieve midis dy vendeve. Shumica e serbëve nuk presin të shohin normalizimin e marrëdhënieve me shqiptarët e Kosovës pavarësisht rezultatit të dialogut;
- Perceptimi i qytetarëve për dialogun Kosovë-Serbi mbase sugjeron që ata nuk e shohin procesin si normalizim midis shoqërive të të dyja vendeve, por më parë si normalizim midis institucioneve shtetërore. Marrëveshjet dhe arritjet në dialogun e Brukselit nuk duket se do të përkthehen njëloj edhe në shoqërinë si të tërë. Me fjalë të tjera, marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë që do të shërbente për arritjen e normalizimit, nuk do të nënkuptojë të njëjtën gjë për qytetarët në të dyja vendet. Andaj, procesi i normalizimit të marrëdhënieve nuk duhet të zëvendësojë domosdoshmërinë e qartë që tregojnë këto rezultate për një proces pajtimi dhe shërimi midis popujve të Serbisë dhe Kosovës.

**FIGURA A GJETJET KRYESORE NGA REZULTATET E PERCEPTIMEVE TË QYTETARËVE TË KOSOVËS DHE SERBIË PËR DIALOGUN (BSBP 2020)**

SHUMICA E TË ANKETUARVE NË TË DYJA VENDET JANË NË FAVOR TË DIALOGUT:

**KOSOVË**  
68%

**SERBI**  
51%

ATA NUK IA DALIN TË IDENTIFIKOJNË NDONJË PËRFITIM PERSONAL NGA DIALOGU:

**KOSOVË**  
80%

**SERBI**  
92%

SHUMICA DËRRMUESE E QYTETARËVE NË TË DYJA VENDET NUK KANË NJOHURI LIDHUR ME PËRMBAJTJEN E DIALOGUT:

**KOSOVË**  
11%

**SERBI**  
18%

MBI 3/4 E TYRE MENDOJNË SE PROCESI I DIALOGUT ËSHTË PJESËRISHT OSE PLOTËSISHT JO-TRANSPARENT:

**KOSOVË**  
77%

**SERBI**  
82%

QYTETARËT NË SERBI DUKEN MË PESIMISTË RRETH MARRËDHËNIEVE PAQËSORE MIDIS TË DYJA VENDEVE SESA ATA NË

**KOSOVË**  
49%

KOSOVË:

**SERBI**  
27%

# KAPITULLI I:

## PERPEKTIVA E QYTETARËVE TË KOSOVËS

Interpretimi i të dhënave nga:  
**Plator Avdiu, Hulumtues (QKSS)**

Asistente hulumtuese:  
**Arta Berisha**

# 1.1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE


- Shumica dërrmuese e të anketuarve në Kosovë (68 për qind) janë mbështetës të dialogut Kosovë-Serbi. Sidoqoftë, është alarmante për institucionet e Kosovës dhe lehtësuesit e dialogut që 80 për qind e tyre nuk ndejnë të kenë pasur në vetvete ndonjë përfitim nga dialogu;
- Gjithsej 77 për qind e të anketuarve në Kosovë ndanë pikëpamjet se procesi i dialogut ka qenë kryesisht ose plotësisht jo-transparent ndaj publikut, ndërsa 60 për qind e tyre mendojnë se Marrëveshjet e Brukselit nuk ka ndryshuar asgjë sa i përket marrëdhënieve të ndërsjella Kosovë-Serbi. Si rrjedhojë, rreth 31 për qind e të gjithë të anketuarve nuk kanë informata se cili është qëllimi i Qeverisë së Kosovës për dialogun me Serbinë;
- Siç pritej, më shumë se  $\frac{3}{4}$  e të anketuarve (77 për qind) besojnë se zgjidhja më e mirë e dialogut duhet të përmbillet me njohjen e ndërsjellë midis Kosovës dhe Serbisë. Lidhur me shkëmbimin e territoreve dhe themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë, të anketuarit janë kategorikisht kundër të dyja opsioneve - 89 për qind kundërshtojnë shkëmbimin e territoreve dhe 83 për qind e tjerë kundërshtojnë Asociacionin;
- Raporti thekson se 58 për qind e të anketuarve nuk e dinë se ç'është ideja e Mini Shengenit për Ballkanin Perëndimor dhe vetëm 38 për qind e kosovarëve do të mbështesnin krijimin e Mini Shengenit në rajon;
- Kosovarët nuk janë shumë optimistë se kur do të arrihet marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë - rreth 48 për qind e të anketuarve besojnë se marrëveshja do të arrihet në 3-5 vitet e ardhshme. Përkundër kësaj, në rast se nuk do të ketë marrëveshje ndërmjet dyja vendeve, atëherë rreth 70 për qind e të anketuarve perceptojnë se Kosova do të përballet me pasoja të rënda negative;
- Të anketuarit besojnë se anëtarësimi i Kosovës në BE varet drejtpërdrejt nga dialogu me Serbinë - 79 për qind e tyre mendojnë se integrimi i Kosovës në BE mund të arrihet vetëm nëse do të kishte një marrëveshje përfundimtare të të dyja vendeve. Nga ana tjetër, të dërguarit specialë të ShBA-së dhe BE-së gëzojnë një nivel shumë të ulët besimi nga të anketuarit në Kosovë për rolin e tyre në dialog;
- Sa i përket çështjeve praktike të Kosovës me Serbinë, rreth 67 për qind e të anketuarve nuk do të ndiheshin të sigurt për të udhëtuar në Serbi me targa të makinave të Kosovës. Për më tej, komunikimi midis shqiptarëve të Kosovës dhe qytetarëve serbë është mjaft sporadik për shkak se rreth 60 për qind e të anketuarve në Kosovë janë përgjigjur se ata kurrë nuk kanë takuar ndonjë qytetar serb.

## 1.2. PIKËPAMJET E KOSOVARËVE PËR DIALOGUN KOSOVË-SERBI

Puna në terren e anketës së BSBP-së në Kosovë i realizuar në vitin 2020 ka dhënë rezultate provokuese për dialogun aktual Kosovë-Serbi të lehtësuar nga Bashkimi Evropian ose Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Edhe pse të anketuarit në vend nuk janë kundër dialogut (68 për qind e tyre mbështesin dialogun), megjithatë më shumë se ¼ e të anketuarve (80 për qind) mendojnë se asnjë përfitim personal nuk është ndjerë nga vetë dialogu deri më sot.

Nuk është për t'u habitur që disa ide të qarkulluara në diskursin publik, si shkëmbimi i territoreve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë ose Asociacioni i komunave me shumicë serbe, kundërshtohen brutalisht nga shumica e të anketuarve në Kosovë duke filluar nga 80 për qind deri tek 89 për qind të tyre që nuk i mbështesin këto opsione. Anketa ka theksuar se më shumë se gjysma e të anketuarve (58 për qind) nuk e dinë se çka fshihet pas idesë së Mini Shengenit për Ballkanin Perëndimor, ndërsa vetëm 38 për qind e kosovarëve janë mbështetës për krijimin e Mini Shengenit.

**FIGURA 1 GRUP PYETJESH LIDHUR ME DIALOGUN KOSOVË - SERBI**




Të anketuarit janë shprehur se ata nuk kanë njohuri për përmbajtjen e dialogut Kosovë-Serbi për shkak se procesi nuk ka qenë transparent - ¾ e të anketuarve (rreth 77 për qind) mendojnë se as Qeveria e Kosovës dhe as lehtësuesit e dialogut nuk kanë qenë transparentë në këtë drejtim. Për më tej, më shumë se gjysma e të anketuarve ose 60 për qind e tyre


ndajnë mendimin se marrëveshjet e dialogut (Marrëveshja e Brukselit mes Kosovës dhe Serbisë) nuk kanë ndryshuar asgjë mes dyja vendeve.

Për shkak të mungesës së transparencës dhe llogaridhënies në procesin e dialogut, të anketuarit kosovarë në numër relativisht të lartë nuk e dinë se cili është qëllimi i Qeverisë së Kosovës në dialogun me Serbinë. Ndërsa, 37 për qind e tyre deklaruan se njohja e ndërsjellë e të dy vendeve është objektivi i Kosovës, më shumë se ¼ (ose 31 për qind) e të anketuarve nuk e dinë se cili është qëllimi i Kosovës në dialog, siç tregon figura më poshtë.


**FIGURA 2 A KENI NJOHURI PËR PËRMBAJTJEN E DIALOGUT?**



**FIGURA 3 SI E VLERËSONI DIALOGUN DERI MË TANI?**




**FIGURA 4 A E DINI CILI ËSHTË QËLLIMI I KOSOVËS NË DIALOGUN ME SERBINË (PYETJE E HAPUR)?**




Kur u pyetën për zgjidhjen më të mirë për Kosovën si rezultat i dialogut, rreth 77 për qind e

të anketuarve deklaruan se njohja e ndërsjellë e Kosovës nga Serbia brenda kufijve ekzistues duhet të jetë zgjidhja ideale e dialogut, krahasuar me 11 për qind të të anketuarve që ishin shprehur kundër arritjes së ndonjë marrëveshjeje me Serbinë. Në anën tjetër, vetëm 18 për qind e të anketuarve nga Kosova mbështesin qëndrimin e Qeverisë së Kosovës për dialogun me Serbinë, duke treguar kështu që Qeveria aktuale e Kosovës përballet me një krizë të besimit publik në dialog.

**FIGURA 5 CILA DO TË ISHTE ZGJIDHJA MË E MIRË PËR DIALOGUN?**




**FIGURA 6 A E MBËSHTESNI QËNDRIMIN AKTUAL TË KOSOVËS PËR DIALOGUN?**



Të anketuarit në Kosovë nuk janë shumë optimistë se kur do të arrihet marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Sidoqoftë, vlen të përmendet se pothuajse gjysma e tyre ose 48 për qind e të anketuarve mendojnë se marrëveshja do të arrihet në 3-5 vitet e ardhshme, ndërsa 43 për qind të tjerë presin të ndodh normalizimi i marrëdhënieve midis dy shteteve vetëm nëse arrihet një marrëveshje përfundimtare. Përveç kësaj, pothuajse 1/2 e të anketuarve besojnë se Kosova dhe Serbia do të kenë marrëdhënie normale dhe paqësore në të ardhmen e afërt.

**FIGURA 7 KUR MENDONI SE DO TË ARRIHET MARRËVESHJA PËRFUNDIMTARE NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË?**




**FIGURA 8** A MENDONI SE DO TË KETË PAQE MES SHQIPTARËVE DHE SERBËVE NË BALLKAN?



**FIGURA 9** A BESONI SE KOSOVA DHE SERBIA, NË NJË TË ARDHME TË AFËRT, DO TË KENË MARRËDHËNIE PAQËSORE DHE NORMALE ME NJËRA-TJETRËN?




**FIGURA 10** A PRISNI TË NDODH NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE MES SHQIPTARËVE TË KOSOVËS DHE SERBËVE NË TË ARDHMEN E AFËRT?



Të dhënat e anketës dëshmojnë se të anketuarit janë në favor të arritjes së marrëveshjes përfundimtare përmes dialogut dhe bazuar në perceptimet e tyre, mungesa e marrëveshjes do të sillte pasoja negative për Kosovën në aspektin e brendshëm e të jashtëm. Siç tregon figura vijuese, rreth 70 për qind e të anketuarve mendojnë se nëse nuk do të ketë marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, atëherë do të ketë pasoja në krahasim me 13 për qind e të anketuarve që shprehen se Kosova nuk do të ketë fare pasoja.


**FIGURA 11** CILAT DO TË ISHIN PASOJAT NËSE NUK ARRIHET MARRËVESHJA NDËRMJET KOSOVËS DHE SERBISË (PYETJE E HAPUR)?




Prandaj, përmbyllja e procesit të dialogut me zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dypalëshe midis Kosovës dhe Serbisë, përfshirë marrëveshjen përfundimtare, është më se e nevojshme që Kosova të anëtarësohet në Bashkimin Evropian. Kjo rrjedh nga 79 për qind e të anketuarve që besojnë se anëtarësimi i Kosovës në BE mund të arrihet vetëm nëse do të kishte një marrëveshje përfundimtare me Serbinë.

Krahas kësaj, është me interes të theksohet se të dërguarit specialë të dialogut - që përfaqësojnë ShBA-në (Richard Grenell) dhe BE-në (Miroslav Lajčák) - gëzojnë nivel shumë të ulët të besimit nga të anketuarit në Kosovë.

**FIGURA 12 A ËSHTË E NEVOJSHME TË ARRIHET MARRËVESHJA PËRFUNDIMTARE ME SERBINË PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË BE?**



**FIGURA 13 SI E VLERËSONI ROLIN E TË DËRGUARVE SPECIALË TË SHBA-VE DHE BE-SË NË DIALOG?**






# 1.3. PERCEPTIMET E IDENTITETIT NDAJ SERBISË

Duke pasur parasysh situatën e ndjeshme politike me Serbinë dhe veçanërisht luftën e shkatëruar nga Serbia në Kosovë kundër popullatës shqiptare të Kosovës në vitet 1990 të shekullit të kaluar, të anketuarit kosovarë (me theks të veçantë popullsia me shumicë shqiptare) ende ndajnë perceptime mjaft negative ndaj qytetarëve të Serbisë (me këtë rast nuk bëhet fjalë për qytetarët e komunitetit serb që jeton në Kosovë dhe i cili është i integruar mirë në vend).

Në këtë drejtim, pothuajse të gjithë të anketuarit në Kosovë ose 93 për qind e tyre nuk do të pranonin që anëtarët e familjes së tyre të martoheshin me një serb/e dhe as serbët të ishin mësimdhënës të fëmijëve/nipërve/mbesave të tyre. Rreth 2/3 e të anketuarve janë kundër idesë që qytetarët serbë të jenë zyrtarë publikë në Kosovë, ndërsa për 70 për qind të tyre nuk do të ishte e pranueshme të kishte një serb si epror në punë.

Nga ana tjetër, duke marrë parasysh fushat e tjera, si të jetuarit në Kosovë ose të pasurit e një kolegu serb në punë, të anketuarit në Kosovë kanë ndarë perceptime disi të ekuilibruara.


**FIGURA 14** A DO TË PRANONIT NJË QYTETAR/E SERB/E TË:




Një çështje tjetër me rëndësi e lidhur me sigurinë që është diskutuar gjerësisht në dialogun e lehtësuar nga BE-ja është liria e lëvizjes për qytetarët e Kosovës për të udhëtuar në/përmes Serbisë. Sidoqoftë, ekziston një shqetësim i madh meqë rreth 67 për qind e të anketuarve nuk do të ndiheshin të sigurt për të udhëtuar në Serbi me targa të Kosovës krahasuar me vetëm 14 për qind që u përgjigjën se do të ndiheshin të sigurt.

Për më tej, duket se ndërveprimi midis qytetarëve shqiptarë dhe serbë të Kosovës është mjaft sporadik, duke marrë parasysh se rreth 60 për qind e të anketuarve në Kosovë janë përgjigjur se nuk kanë takuar asnjëherë ndonjë qytetar serb. Ndërsa, më pak se 40 për qind e tyre kanë takuar ndonjë serb. Përkundër këtyre rezultateve, është shumë me rëndësi të theksohet se burimet kryesore të informacionit në lidhje me marrëdhëniet Kosovë-Serbi për të anketuarit kosovarë janë TV (70 për qind) dhe Interneti (25 për qind).


**FIGURA 15 SA I SIGURT DO TË NDIHESHIT PËR TË UDHËTUAR NË SERBI ME TARGA TË MAKINAVE TË KOSOVËS?**



**FIGURA 16 A KENI TAKUAR NDONJËHERË NDONJË QYTETAR SERB?**



**FIGURA 17 KU I MERRNI INFORMATAT PËR MARRËDHËNIET KOSOVË-SERBI?**





**BCSP** Belgrade Centre  
for Security Policy

## **KAPITULLI II:**

# **PERSPEKTIVA E QYTETARËVE TË SERBISË**

**Interpretimi i të dhënave:**

**Bojan Elek, Hulumtues (BCSP)**


## 2.1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Megjithëse shumica e qytetarëve serbë i besojnë Qeverisë dhe mbështesin marrëveshjen që do ta zgjidhte çështjen e Kosovës, gjysma e tyre nuk janë të vetëdijshëm se cili është qëllimi përfundimtar në negociatat me Prishtinën. Vetëm një e pesta mendon se qëllimi është të ruhet integriteti territorial i Serbisë (në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së), ndërsa gjysma besojnë se ky do të ishte edhe rezultati ideal i negociatave. Sidoqoftë, qytetarët serbë kanë mendime kryesisht negative për shqiptarët e Kosovës, të cilat, së bashku me skepticizmin mbi rezultatet e dialogut dhe mundësinë e paqes midis dy grupeve etnike, flasin për ekzistencën e disonancës njohëse. Me fjalë të tjera, qytetarët kanë dëshirë të fortë që ta kthejnë Kosovën, por nuk do të pranonin që shqiptarët e Kosovës të kishin ndonjë rol të spikatur në jetën publike në Serbi. Ekzistenca e këtyre ideve kontradiktore mund të gjurmohet gjatë gjithë kohës: qytetarët serbë mbështesin dialogun Beograd-Prishtinë, por nuk mund të imagjinojnë një bashkëjetesë paqësore midis serbëve dhe shqiptarëve; ata tregojnë mbështetje për marrëveshjet e arritura në Bruksel, por nuk shohin ndonjë përfitim prej tyre etj. Të dhënat tregojnë qartë një fuqi të butë të konsiderueshme në duart e Qeverisë serbe dhe aftësinë e saj për ta ndikuar dhe formësuar opinionin publik të qytetarëve, veçanërisht kur merret parasysh se një shumicë e konsiderueshme (64 për qind) kryesisht mbështetet në televizion për informacion, veçmas në transmetuesin publik (RTS). Andaj, Qeveria padyshim që ka mjetet për të ndikuar tek qytetarët dhe për të fituar besimin e tyre të palëkundur, por nuk i shfrytëzon ato për të normalizuar marrëdhëniet midis dy komuniteteve dhe popujve.


## 2.2. PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR DIALOGUN MES KOSOVËS DHE SERBISË

Qytetarët serbë janë veç pjesërisht të informuar lidhur me përmbajtjen e dialogut Beograd-Prishtinë dhe shumica mendon se i gjithë procesi nuk ka qenë mjaftueshëm transparent. Pavarësisht kësaj, gjysma e të anketuarve mbështesin dialogun, ndonëse 90 për qind nuk ndiejnë ndonjë përfitim të prekshëm dhe ¾ mendojnë se dialogu pothuajse nuk kishte asnjë efekt. Në këtë mënyrë, qytetarët duket se besojnë që dialogu ka potencialin për të zgjidhur çështjet e pazgjidhura, por prapë mendojnë se është humbur kohë në trajtimin e çështjeve dytësore që nuk sjellin rezultate pozitive. Rolet e të dërguarve specialë, si ai i Richard Grenell të ShBA-së dhe Miroslav Lajcak të BE-së, shihen pozitivisht nga një shumicë e vogël e të anketuarve.


**FIGURA 18** A KENI NJOHURI PËR PËRMBAJTJEN E DIALOGUT KOSOVË-SERBI?



**FIGURA 19** A E MBËSHTESNI DIALOGUN KOSOVË - SERBI?




**FIGURA 20** SI E VLERËSONI DIALOGUN KOSOVË-SERBI DERI MË TANI?



**FIGURA 21** A NDJENI PERSONALISHT NDONJË PËRFITIM NGA DIALOGU KOSOVË-SERBI?



Gjysma e qytetarëve nuk e dinë se cilat janë qëllimet e Serbisë në negociatat me Kosovën (Figura 17). Një e pesta e të anketuarve mendon se është ruajtja e Kosovës brenda Serbisë, 10 për qind besojnë se është zgjidhja paqësore e konfliktit dhe vetëm 6 për qind presin njohje të ndërsjellë. Sidoqoftë, 2/3 mbështesin agjendën e Serbisë në dialog dhe në të vërtetë kjo dëshmon për vlerësim të dobët kritik të vendimeve të Qeverisë, por gjithashtu flet shumë për besimin e madh e të verbër në qëllimet e tyre. Meqë 2/3 e qytetarëve kryesisht marrin informacionin për Kosovën nga TV, mungesa e njohurive lidhur me qëllimet mund të vijë edhe prej raportimit kryesisht të fokusuar në proces, me pak analiza të përmbajtjes, por edhe prej komunikimit të paqartë nga Qeveria dhe mungesës së drejtimit të qartë të politikës.

**FIGURA 22** A E DINI CILI ËSHTË QËLLIMI I SERBIË NË DIALOG?

Shumica dërrmuese e të anketuarve prej 85 për qind e kanë konsideruar të papranueshëm propozimin për 'shkëmbime të territoreve', megjithëse kjo ide është diskutuar jozyrtarisht si zgjidhje e mundshme në një moment të caktuar.


## MBI REZULTATET IDEALE TË DIALOGUT

Pothuajse gjysma e të gjithë qytetarëve mendojnë se kthimi i Kosovës në Serbi me dhënien e një autonomie më të gjerë do të ishte rezultati më i mirë i dialogut (Figura 20). Një e pesta mendon se zgjidhja më e mirë është krijimi i Asociacionit të komunave serbe për garantimin e të drejtave të pakicave, pa ndodhur njohja. Ndërkaq, mosarritja e marrëveshjes është ideale për 15 për qind të qytetarëve, 8 për qind mbështetin njohjen e ndërsjellë brenda kufijve ekzistues, 6 për qind mbështetin ndarjen e Kosovës dhe bashkimin e komunave veriore të Kosovës me Serbinë, ndërsa vetëm 4 për qind janë në favor të shkëmbimit të territoreve. Njëkohësisht, 40 për qind mendojnë se njohja e pavarësisë së Kosovës nuk do të ndikonte aspak në jetën e tyre, ¼ në këtë rast do të ndiheshin sikur kanë humbur identitetin e tyre dhe 1/5 do të ndiheshin të poshtëruar. Këto shifra tregojnë për faktin se lidhja me Kosovën është kryesisht me karakter emocional ose shpirtëror, si dhe nuk bazohet medoemos në argumente racionale.

Ky interpretim vërtetohet nga fakti se asociimet më të shpeshta për Kosovën tek të anketuarit janë manastiret dhe trashëgimia serbe, zemra e Serbisë dhe djepi i serbëve, si dhe identiteti serb. Nuk është befasi që qytetarët besojnë se Kosova u shkëlqon nga Serbia, ata identifikohen fuqishëm me të dhe mendojnë se zgjidhja e vetme është që ajo të kthehet në Serbi.


Andaj, qytetarët nuk heqin dorë nga Kosova, ndërsa në të njëjtën kohë dëshirojnë pajtim dhe marrëdhënie normale, megjithëse mendojnë se negociatat aktuale nuk po shkojnë në atë drejtim. Këtu buron skepticizmi në lidhje me rezultatet e dialogut, meqë gjysma e qytetarëve nuk besojnë se marrëveshja përfundimtare do të arrihet ndonjëherë dhe vetëm ¼ mendojnë se mund të arrihet brenda 3-5 viteve të ardhshme. Dy të tretat e qytetarëve mendojnë se nuk ka perspektivë për normalizimin e marrëdhënieve në planin afatshkurtër, pavarësisht nga rezultatet e dialogut, ndërsa të tjerët mendojnë se arritja e një marrëveshje është parakusht për këtë çështje. Kjo është edhe arsyeja pse 70 për qind mendojnë që nuk mund të ketë paqe mes serbëve dhe shqiptarëve në Ballkan në një të ardhme të parashikueshme. Veç mungesës së rezultateve të prekshme nga dialogu, ky pesimizëm mund të kuptohet edhe duke marrë parasysh distancën e madhe etnike ndaj shqiptarëve, e cila është vazhdimisht e pranishme dhe promovohet në sferën publike.

**FIGURA 23** CILI DO TË ISHTE REZULTATI IDEAL PËR DIALOGUN?




**FIGURA 24** A BESONI SE KOSOVA DHE SERBIA DO TË KENË MARRËDHËNIE PAQËSORE DHE NORMALE NË TË ARDHMEN E AFËRT?

**FIGURA 25** A BESONI SE DO TË KETË PAQE NË MES TË SHQIPTARËVE DHE SERBËVE NË BALLKAN?



**FIGURA 26** SIPAS MENDIMIT TUAJ, KUR DO TË ARRIHET MARRËVESHJA FINALE MES KOSOVËS DHE SERBISË?




**FIGURA 27** A PRISNI TË NDODH NORMALIZIMI I MARRËDHËNIEVE MES SHQIPTARËVE TË KOSOVËS DHE SERBËVE NË TË ARDHMEN E AFËRT?



## 2.3. PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR ÇËSHTJET E IDENTITETIT

Edhe pse gjysma e qytetarëve serbë kanë dëshirë të fortë që ta shohin Kosovën të kthyer, një shumicë e madhe e konsideron të papranueshme që shqiptarë të Kosovës të jenë në ndonjë pozitë të rëndësishme në shoqëri sepse mendojnë se dallimet ekzistuese paraqesin pengesë shumë të madhe. <sup>3</sup>/<sub>4</sub> nuk do t'i pranonin shqiptarët e Kosovës si zyrtarë publikë në Serbi ose që të martoheshin brenda familjeve të tyre, ndërsa 2/3 nuk do të donin t'i shihnin si mbikëqyrës të tyre në punë.

**FIGURA 28** A DO TË ISHTE E PRANUESHME PËR JU NËSE NJË SHOQIPTAR/E I/E KOSOVËS:




Njëherësh, 2/3 nuk kanë kontakte në Kosovë dhe më shumë se gjysma e të anketuarve nuk kanë takuar asnjëherë ndonjë shqiptar të Kosovës. Sidoqoftë, ata që kanë takuar shqiptarë të Kosovës kanë përshtypje shumë pozitive. Një gjetje inkurajuese është se 2/3 e qytetarëve do të pranonin shqiptarët e Kosovës të jetojnë në Serbi ose t'i kenë fqinjë. Pavarësisht kësaj, 4/5 ende mendojnë se ka më shumë dallime sesa ngjashmëri ndërmjet të dyja grupeve etnike, duke përmendë fenë, gjuhën dhe kulturën si dallimet më të theksuara.

**FIGURA 29** A MENDONI SE KA MË SHUMË NGJASHMËRI APO MË SHUMË DALLIME MES SERBËVE DHE SHOQIPTARËVE?



**FIGURA 30** A KENI TAKUAR NTONJËHERË SHOQIPTAR TË KOSOVËS?







# METODOLOGJIA

Barometri i Sigurisë së Ballkanit Perëndimor është kombinim i metodave kualitative dhe kuantitative të hulumtimit që ofrojnë rezultate objektive dhe të besueshme. Të dhënat grumbullohen përmes teknikës së intervistave ballë për ballë me të anketuarit që zgjedhën sipas metodës së rastësisë në të gjithë territorin e të dyja vendeve ku është bërë hulumtimi në terren - Kosovë dhe Serbi. Hulumtimi në terren u realizua nga fundi i shtatorit deri në fillim të tetorit 2020, nga ekipet hulumtuese të terrenit të Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë në Kosovë dhe agjencisë Sprint në Serbi.

Pyetëtori kryesisht përbëhej nga pyetje të mbyllura në formën e Shkallës Likert prej pesë pikëve, me disa pyetje të hapura që u lejojnë të anketuarve të japin mendimet pa opsione të paracaktuara. Mostra kombëtare në Kosovë nga e cila u krye hulumtimi përfshinte 1,132 familje, duke përbërë kështu një mostër përfaqësuese të popullsisë mbi 18 vjeçe në Kosovë. Mostra u bazua në zonat e kodit telefonik dhe, si e tillë, përfshinte 8 rrethet si në vijim: Ferizaj, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë Jugore, Mitrovicë Veriore, Pejë, Prishtinë dhe Prizren. Faza e parë e grumbullimit gjeografik u bazua në Raportin e Regjistrimit të Popullsisë në Kosovë për vitin 2012. Faza e dytë përfshinte grumbullimin e mostrave sipas zonës komunale me një mostër të shtresuar rurale/urbane sipas numrit të familjeve. Faza e fundit ndoqi një metodë të mostrës së rastësishme duke përdorë 'metodën e ditëlindjes' më të afërt. Mostra e rastësishme siguron që secili banor në Kosovë të ketë probabilitet të barabartë për t'u intervistuar. Me shembullin e përdorur për këtë studim, rezultatet e anketës pasqyrojnë trendin e qëndrimeve dhe perceptimeve në mesin e tërë popullatës së rritur të Kosovës në përgjithësi.

Sa i përket Serbisë, anketa u krye me një mostër përfaqësuese prej 1,095 të anketuarve të rritur duke mbuluar 120 vendvotime të shtresuara në nëntë shtresa sipas madhësisë së qendrës së votimit (i vogël/i mesëm/i madh) dhe ka përfshirë rajonin e Vojvodinës, Beogradit dhe Serbisë Qendrore. Në secilën shtresë, numri i vendvotimeve në të cilat u zhvillua hulumtimi në terren u përcaktua në përputhje me pjesën e popullsisë në ato shtresa në raport me popullatën e përgjithshme të votuesve sipas listës së zgjedhësve nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2020: "Vojvodina e vogël" - 1; "Vojvodina e mesme" - 10; "Vojvodina e madhe" - 20; "Beogradi i vogël" - 0; "Beogradi i mesëm" - 4; "Beogradi i madh" - 26; "Serbia Qendrore e vogël" - 9; "Serbia Qendrore e mesme" - 20; "Serbia Qendrore e madhe" - 30. Brenda secilës nga nëntë shtresat, mostra ishte e rastësishme, me tri faza: vendvotimet e zgjedhura brenda secilës shtresë u përcaktuan me metodën PPM (probabiliteti i përpjesëtueshëm sipas madhësisë së mostrës), familjet në të cilat u krye anketimi u përcaktuan rastësisht, në varësi të llojit të vendbanimit - rural/urban; lloji i ndërtesës - shtëpi/ndërtesë; katet e ndërtesave - ndërtesa të ulëta/të larta; ndërsa i anketuari në një familje u përcaktua nga kriteri i ditëlindjes së parë pasuese.

Të dhënat u verifikuan në kohë reale përmes koordinatorëve të terrenit që vizituan një mostër të paracaktuar të familjeve pas përfundimit të studimit në familjet përkatëse. Verifikimi i të dhënave është bërë edhe kontaktit telefonik me të gjithë të anketuarit për të konfirmuar respektimin e metodologjisë dhe disa prej përgjigjeve kryesore, si dhe analizimin e qëndrueshmërisë logjike të përgjigjeve gjatë përpunimit dhe analizimit të të dhënave. Margjina e gabimit është 3 për qind me një interval besimi prej 95 për qind. Përpunimi dhe analizimi i të dhënave ka përfunduar përmes softuerit SPSS.

Figurat e mëposhtme paraqesin të dhënat demografike të të anketuarve në Kosovë dhe Serbi në kuadër të BSBP për vitin 2020:

**FIGURA I** TË ANKETUARIT E BSBP 2020 SIPAS RAJONEVE NË KOSOVË DHE SERBI

KOSOVË		SERBI	
RAJONI	% E TË ANKETUARVE	RAJONI	% E TË ANKETUARVE
Prishtinë	22%	Vojvodinë	27%
Mitrovicë Jugore	11%	Beograd	24%
Gjilan	12%	Serbi Perëndimore dhe Shumadi	27%
Pejë	13%	Serbi Jugore dhe Lindore	21%
Gjakovë	11%		
Prizren	15%		
Ferizaj	12%		
Mitrovicë Veriore	4%		

**FIGURA II** TË ANKETUARIT E BSBP 2020 SIPAS VENDBANIMIT NË KOSOVË DHE SERBI

KOSOVË		SERBI		
ZONA	% E TË ANKETUARVE	ZONA	% E TË ANKETUARVE	
RURALE	50%	RURALE	NËN-URBANE	URBANE
URBANE	50%	35%	19%	46%

**FIGURA III** TË ANKETUARIT E BSBP 2020 SIPAS PËRFAQËSIMIT GJINOR NË KOSOVË DHE SERBI

KOSOVË		SERBI	
GJINIA	% E TË ANKETUARVE	GJINIA	% E TË ANKETUARVE
MASHKULL	45%	MASHKULL	49%
FEMËR	55%	FEMËR	51%

**FIGURA IV** TË ANKETUARIT E BSBP 2020 SIPAS MOSHËS NË KOSOVË DHE SERBI

MOSHA	% E TË ANKETUARVE	
	KOSOVË	SERBI
18-25	20%	18-34 27%
26-35	16%	35-54 36%
36-45	18%	55 e sipër 37%
46-55	18%	
56-65	14%	
66+	14%	

**FIGURA V** TË ANKETUARIT E BSBP 2020 SIPAS PËRKATËSISË ETNIKE NË KOSOVË DHE SERBI

PËRKATËSIA ETNIKE % E TË ANKETUARVE			
KOSOVË	SERBI		
Shqiptarë të Kosovës	90%	Serbë	91%
Serbë të Kosovës	8%	Të tjerë	9%
Komunitetet tjera jo-shumicë	2%		

Komunitetet e tjera në Kosovë të anketuar nga BSBP gjatë hulumtimit në terren përfshijnë: romë, ashkalinj, egjiptianë, boshnjakë, kroatë, turq dhe goranë.



Katalogimi në botim – **(CIP)**  
Biblioteka Kombëtare e Kosovës“Pjetër Bogdani”

327(496.51:497.11)

Avdiu, Plator

Rruga për te marrëveshja përfundimtare? : perceptimet e qytetarëve në Kosovë dhe Serbi mbi dialogun politik dhe identitetin / Plator Avdiu, Arta Berisha. – Prishtinë : Kosovar Centre for Security Studies, 2021. – 19 f. : ilustr. ; 21 cm.

1.Berisha, Arta

**ISBN 978-9951-799-22-5**



ISBN 978-9951-799-22-5



9 789951 799225